VENDIM
Nr. 97, datë 16.7.2012

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE NGA HE-CET "DARSI 1", "DARSI 2" DHE "DARSI 3" TË SHOQËRISË "HENZ ENERGY", SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa "a" të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.7.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Henz Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et "Darsi 1", "Darsi 2" , "Darsi 3", si burime të rinovueshme energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Henz Energy" sh.p.k., është konform "Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat "a", "b", "c", "d".

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, germat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantet prodhuese nga hecet "Darsi 1", "Darsi 2" dhe "Darsi 3" të shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k., si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani